



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:911628
Datë: 20.07.2023
Numri i dokumentit: 04504997

E.nr.985/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Faton Ajvazi, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorit B.M. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Jakup Ramadani nga Ferizaj, kundër debitorit KRM “P.” SH.A, me seli në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 20.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën **E.nr.985/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.985/23, të datës 27.06.2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit KRM “P.” SH.A, për pagesën e të ardhurave personale dhe shpenzimeve të procedurës, në shumë të përgjithshme prej 3,507.14 euro, në bazë të aktgjykimit C.nr.74/18 dhe C.nr.220/18, të datës 21.01.2018.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 14.07.2023, e ka urdhëruar Bankën për Biznes, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 3,507.14 euro, në llogarinë e kreditorit dhe të autorizuarit të tij.

Nga e-maili i datës 20.07.2023, i dërguar në adresë zyrtare, e-mail zyrtar, B.P.B. e ka njoftuar gjykatën se e ka bërë transferimin e mjeteve nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit, gjegjësisht shumën e mjeteve prej 2,307.14 euro në llogarinë e kreditorit B.M. ndërsa shumën e mjeteve prej 1,200.00 euro në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit, av Jakup Ramadani nga Ferizaj.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.985/23, më datë 20.07.2023

GJYQTARI
Faton Ajvazi